

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 24.10.2025

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, nën paragrafi 1.10 të ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxjerr:

V E N D I M

I. Miratohet Rregulla e Brendshme për Transferimin e të Burgosurve.

II. Rregulla e Brendshme për Transferimin e të Burgosurve do të zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe të gjitha Institucionet Korrektuese gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave për transferimin e të burgosurve.


III. Vendimi hyn në fuqi nga data 01 Nëntor 2025.

Ismail Dibrani

Drejtör i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Vendimi ju dërgohet:

1. Institucioneve Korrektuese;
2. Arkivit të SHKK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

Shërbimi Korrektues i Kosovës

Rregull e Brendshme për Transferimin e të Burgosurve

Prishtinë, Tetor 2025

Në mbështetje të nenit 12, paragraf 1, nën paragraf 1.10 të Ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, nxjerrë:

Rregull të Brendshme për Transferimin e të Burgosurve

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregull e brendshme ka për qëllim të përcaktoj procedurat e vendimarrjes lidhur me transferimin e të burgosurve nga një institucion në institucionin tjetër korrektues.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Transferim** – nënkupton transferin e të burgosurve nga një institucion në institucionin tjetër korrektues me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;

1.2. **I dënuar** - nënkupton personin i cili është dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga gjykata kompetente;

1.3. **I paraburgosur** – nënkupton personin i cili me aktvendim të gjykatës i është caktuar masa e paraburgimit;

1.4. **I burgosur** – nënkupton personat e paraburgosur dhe të dënuar;

1.5. **IK** - nënkupton Institucionin Korrektues;

1.6. **Ekipi multiprofesional** - nënkupton ekipin multiprofesional të institucionit korrektues që përbëhet nga profesionist të fushave të ndryshme të angazhuar në rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve;

1.7. **NJVKB** – Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve;

1.8. **Komisioni** – nënkupton komisionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës për vlerësimin e kërkesave për transferimin e të burgosurve.

Neni 3

Fushëveprimi

Kjo rregull zbatohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe të gjitha institucionet korrektuese gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave për transferimin e të burgosurve.

Neni 4

Arsyet e transferimit të burgosurve nga një institucion në institucionin tjetër korrektues

1. Të burgosurit mund të transferohen nga një institucion korrektues në tjetrin nëse kjo është e nevojshme për:

- 1.1. zbatimin e programit të tij korrektues dhe risocializues ose programin e punës;
- 1.2. inkurajimin e kontakteve ndërmjet personit të dënuar dhe familjes së tij dhe rrethit shoqëror me qëllim të lehtësimit të riintegrit të tij përfundimtar në shoqëri;
- 1.3. shkaqet e mbrojtjes dhe sigurisë të personit të dënuar;
- 1.4. interes të ruajtjes së rendit dhe disiplinës brenda institucionit korrektues;
- 1.5. shkak të trajtimit shëndetësor;
- 1.6. zbatim të suksesshëm dhe të arsyeshëm të procedurës penale;
- 1.7. situata të emergjencave si tërmetet, vërshimet, zjarret, pandemitë etj.

Neni 5

Kriteret për transferimin dhe qëndrimin e të dënuarve në qendrat e paraburgimit

1. Si rregull personat e dënuar mund të transferohen në qendrat e paraburgimit nëse mbetja e dënimit nuk kalon ma shumë së një (1) vit me qëllim të përmbushjes së nevojave të institucioneve korrektuese për inkuadrimin e personave të dënuar në punë profesionale dhe teknike.
2. Përjashtimisht në qendrat e paraburgimit mund të transferohen personat e dënuar që kanë mbetje të dënimit mbi një (1) vit për rrethana të veçanta si transferim i përkohëshëm deri në gjashtë (6) muaj me mundësi rivlerësimi pas kësaj periudhe.
3. Transferimi i personave të dënuar në qendrat e paraburgimit mund të bëhet varësisht nga kapaciteti i shtretërve të përcaktuar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për vendosjen e personave të dënuar.

Neni 6

Transferimi i personave të paraburgosur në qendrat korrektuese

1. Të paraburgosurit mund të transferohen për trajtim mjekësor në qendrat korrektuese në koordinim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve përkatësisht Njësitë Shëndetësore të Burgjeve bazuar në rekomandimin e komisionit multidisiplinar shëndetësor dhe mund të qëndrojnë deri në përfundimin e trajtimit.
2. Të paraburgosurit e dënuar në shkallën e parë me kërkesë të tyre mund të transferohen në qendrat korrektuese për fillim të ekzekutimit të dënimit si dhe me qëllim të menaxhimit efikas të vendeve në qendrat e paraburgimit.
3. Të paraburgosurit e dënuar në shkallën e parë të cilët transferohen në qendrat korrektuese me kërkesë të institucionit korrektues vendosen ndaras nga personat me dënime të plotëfuqishme.

Neni 7

Procedura për transferim të burgosurve

1. Procedura e transferimit të burgosurve fillon me parashtrimin e kërkesës nga:
 - 1.1. i burgosuri apo i autorizuari i tij;
 - 1.2. drejtori i institucionit;
 - 1.3. anëtari i ngushtë i familjes së personit të burgosur;
2. Shërbimi Korrektues i Kosovës nëse e vlerëson të nevojshme i njofton organet përkatëse si Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat lidhur me transferimin e të burgosurve nga një institucion në tjetrin në rastet specifike.

3. Kur gjykata, prokuroria dhe policia kërkojnë që të burgosurit të transferohen nga një institucion korrektues në tjetrin, Shërbimi Korrektues i Kosovës e realizon transferimin e kërkuar.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesës për transfer

1. Në rast kur kërkohet transferimi i të burgosurit nga një institucion në institucionin tjetër korrektues, drejtori i institucionit ku është i vendosur i burgosuri do ta trajtoj kërkesën dhe pas përcaktimit të elementeve të përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulle do të kërkoj nga zyrtarët profesional të vlerësojnë dhe plotësojnë formularin përkatës.

2. Zyrtarët për programe apo çështje sociale gjatë procedurës së vlerësimit për transferim duhet të bazohen në nevojat e transferimit dhe në rast se transferimi kërkohet për zbatimin e programit të tij korrektues dhe risocializues ose programin e punës duhet të sqaroj pse i burgosuri nuk ka pasur mundësi për ndjekjen e programeve rehabilituese apo programit të punës gjatë qëndrimit në institucion.

3. Në rastet kur transferimi kërkohet për inkurajimin e kontakteve ndërmjet personit të burgosur dhe familjes së tij dhe rrethit shoqëror, me qëllim të lehtësimit të riintegrit të tij përfundimtar në shoqëri, zyrtari për çështje sociale duhet të paraqes gjendjen aktuale të realizimit të vizitave gjatë qëndrimit në institucionin korrektues, vendbanimin apo vendqëndrimin e familjes së të burgosurit, vështërsit apo pengesat të cilat mund të ndikojnë në riintegrimin e tij duke sqaruar se transferimi i tij në institucionin tjetër korrektues mund të lehtësoj riintegrimin.

4. Nëse kërkesa për transferim është për shkaqet e mbrojtjes dhe sigurisë të personit të dënuar, divizioni i sigurisë dhe i pavijonit ku është duke qëndruar i burgosuri duhet të plotësojnë formularin përkatës duke dhënë sqarime për shkaqet e rrezikut që i kanosen të burgosurit dhe masat e ndërmarra gjatë qëndrimit të tij në atë institucion dhe arsyeshmerinë e nevojës për transferim në institucionin tjetër korrektues.

5. Nëse kërkesa për transferimin e të burgosurit është në interes të ruajtjes së rendit dhe disiplinës brenda institucionit korrektues, divizioni i sigurisë dhe i pavijonit ku është vendosur i burgosuri duhet të plotësojnë formularin përkatës duke dhënë sqarime lidhur me rrethanat që janë në interes të ruajtjes së rendit dhe disiplinës brenda institucionit korrektues.

6. Në raste kur kërkesa për transferim për arsye të trajtimit shëndetësor e paraqitur nga familjarët e të burgosurit apo i autorizuari i tij e njejta adresohet në Njësinë Shëndetësore të Burgjeve me qëllim të marrjes së informacioneve se i njejti është duke marr trajtim adekuat shëndetësor apo ka nevojë për trajtim shtesë i cili nuk mund ti ofrohet në institucionin aktual.

7. Kur vlerësimi i kërkesave del të jetë i arsyeshëm, drejtori i institucionit mund ti propozoj Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës që i burgosuri të transferohet në institucionin tjetër korrektues.

8. Përfundimisht kur kërkesa për transferim është që i dënuari të transferohet në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë, drejtori i institucionit ku është i vendosur i dënuari duhet të sigurohet se i njejti i plotëson kriteret e përcaktuara në rregullën për tretmane për vendosjen në institucionin korrektues të tipit të hapur.

9. Në rastet kur kërkesa nuk i përmbush kriteret e përcaktuara për transferim, drejtori i institucionit e njofton të burgosurin me shkrim përmes formularit përkatës se kërkesa nuk mund të procedohet për shqyrtim të metutjeshëm te Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 9

Pranimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës i kërkesave për transferim të parashtruara nga të burgosurit dhe familjarët e ngushtë të tyre.

1. Kërkesa për transferim të burgosurve pranohet në Departamentin për Siguri Operativë dhe Përcjellje të Burgosurve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
2. Departamenti për Siguri Operativë dhe Përcjellje të Burgosurve pas pranimi të kërkesës, lëndën e kompletuar e dorëzon në komision.

Neni 10

Roli i komisionit për shqyrtimin e kërkesave për transferim të personave të burgosur

1. Komisioni ka rol vlerësues dhe këshilldhënës për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
2. Pas pranimi të kërkesës nga i burgosuri, i autorizuari i tij apo familjari i ngushtë, komisioni duhet ta adresoj kërkesën të drejtori i institucionit korrektues ku është i vendosur i burgosuri për shqyrtim dhe propozim.
3. Komisioni pas pranimi të propozimit nga drejtori i institucionit e shqyrton kërkesën dhe të gjitha shkresat e lëndës për transferim me qëllim të sigurimit se i burgosuri i plotëson kriteret për transferim në institucionin tjetër korrektues.
4. Komisioni pas shqyrtimit të rastit i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për transferim.
5. Forma e rekomandimit për aprovimin apo refuzimin e kërkesës përcaktohet në formularin unik të transferimit i cili mund të jetë kopje fizike apo elektronike në bazën e të dhënave për të burgosur.

Neni 11

Vendimi për transferim të personit të burgosur

1. Vendimin për transferimin e të burgosurve e merr Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 12

Afati për shqyrtimin e kërkesave për transferim

1. Drejtori i institucionit korrektues pas pranimi të kërkesës për transferimin e të burgosurit është i obliguar që në afat prej 15 ditësh të bëjë vlerësimin dhe të procedojë lëndën për shqyrtim te komisioni.
2. Komisioni është i obliguar që në afat prej 15 ditësh të bëjë vlerësimin e kërkesave të burgosurve për transferim.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës pas pranimi të rekomandimit nga komisioni, brenda afatit prej 5 ditësh merr vendim për aprovim apo refuzim të kërkesave për transferim.

4. Drejtorët e institucioneve korrektuese janë të obliguar që kërkesat për transferim të burgosurve ti dorëzojnë të komisioni javën e parë dhe të tretë të çdo muaji.

5. Për vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Departamenti për Siguri Operativë dhe Përcjelljen e të Burgosurve brenda 24 orëve duhet të njoftojë institucionet përkatëse dhe Njësinë për Përcjelljen e të Burgosurve.

6. Për vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës i burgosuri njoftohet në afat prej 24 orësh.

7. Për transferimet e personave të paraburgosur institucioni korrektues nga i cili transferohet i burgosuri duhet ta njoftojë gjyqtarin e procedurës paraprake të gjykatës kompetente.

Neni 13

Parashtrimi i kërkesave pas transferimit të fundit

1. I burgosuri nuk mund të parashtojë kërkesë të sërishme për transferim për arsye të njejtë, derisa të kalojnë gjashtë (6) muaj nga paraqitja e kërkesës së tij të fundit.

2. Përfundimisht nga paragrafi 1, kërkesa për transferim për çështje shëndetësore dhe të sigurisë mund të parashtrohet pa kaluar afati prej gjashtë (6) muaj.

Neni 14

Vendosjet me rekomandim të NJVKB

1. Kërkesat për vendosjen e të burgosurve në institucionet korrektuese, sipas rekomandimit të NJVKB pranohen dhe shqyrtohen nga komisioni pas kompletimit me raportet përcjellëse të IK.

2. Kur vendosjet realizohen sipas rekomandimit të NJVKB të burgosurit nuk mund të transferohen në ndonjë institucion tjetër pa kaluar gjashtë (6) muaj.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregull e brendshme hyn në fuqi nga data: 01.11.2025. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj rregulle është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe udhëzimet administrative në fuqi vlejné dispozitat ligjore dhe akteve nënligjore.

24.10.2025

Ismail Dibrani
Drejtore i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

